

FATMA MEMALLI

RIKRIJIMI

Roman

BOTIMET TOENA

FITUES I FONDIT TË KRIJIMTARISË "AUTORËT E RINJ - 2026"
MTKS & QKLL

FATMA MEMALLI

RIKRIJIMI

roman

BOTIMET TOENA

PËRMBATJA

Pjesa e parë - Zanafilla e fundit.....	
Pjesa e dytë - Urna e gjallë.....	
Pjesa e tretë - Vetëvdekja.....	
Pjesa e katërt - Shtëpia pas diellit.....	

PJESA E PARË

ZANAFILLA E FUNDIT

Drita e butë mëngjesore përvidhet në dhomë mes të çarave tek-tuk të grilave të pambyllura tërësisht. Si një rrjetë peshkimi e praruar, depërton me lehtësi përtej perdes së hollë e të tejdukshme dhe përthyer kryeneçe ngado mundet: mbi sipërfaqen e librave të shpërndarë rrëmujshtëm nëpër dhomë; mbi tavolinën e drunjtë të punës dhe një pìrg topthash letre të mbledhura shuk, me kush e di ç'shënime të padenja për t'u ruajtur; mbi komodinën përbri shtratit të mbështetur si fortesë në murin ngjyrë kremi dhe, mbi të, një MAC i hirtë, model i vjetruar që prej vitit 2019.

Është një dhomë jo shumë e madhe, praktike, e mobiluar thjesht dhe, për rrjedhojë, me hapësirë të bollshme.

Apartamenti është në pronësi të çiftit të moshuar Valias. Me largimin e fëmijëve të tyre diku në perëndim i janë rikthyer jetës së ngeshme në periferi, larg tymnajës së kryeqytetit.

Ditën kur u takuam, më dorëzuan çelësin dhe, bashkë me të, fëmijën tjetër të tyre: apartamentin. U kujdesën të më linin porosinë e fundit.

- Kjo është tamam një shtëpi për të qenë, - kishte thënë

plot mburrje plaku Valias ditën që liroi shtëpinë. - Për shtresën e artë të mesme, - kishte vijuar ai. - Jo si ato shtëpitë e të pasurve të sotëm, ku zëri, si në ndonjë katedrale të lartë mesjetare të stilit gotik, kumbon si jehonë boshe e të kthehet disa herë mbrapsht. Një zbrazëti e brendshme e projektuar së jashtmi. Nuk është as si ato shtëpitë e skamjes, të dëngura me rrangullina. Arkitektura është si shpirti. Sikur qytetet të qenë njerëz, shpirtrat e tyre do të na rrëfenin gjithçka veç me një vështrim.

Dhe zonja Valias, një grua e mbajtur, fjalëpak e me një qëndrim çmues bashkëshortor, e buzëqeshur, kishte pohuar disa herë me kokë në mbështetje të të shoqit.

Sigurisht, apartamenti është larg dukjes së përsosur, madje edhe larg atij përshkrimi të tapinosur, por nga admirimi që njeriu ka për të vetën, gërshetuar me nostalgjinë e ikjes, ai ngrihet në një pedestal të pakapshëm.

Alarmi i zgjimit bie pareshtur disa herë radhazi.

Gjysmë zgjuar, gjysmë në gjumë, këmbëngul ta fik sërish. Si në zhgjendërr, mundohem të harroj mbrëmjen e kaluar. Telefoni zhvendoset mbi komodinë herë pas here. Asnjëri prej të dyve nuk gjen rehat.

Hiqem sikur nuk dua ta dëgjoj. Sikur, me fashitjen e sinjalit, do të mund të shuaj edhe lumnajën e mendimeve.

Rrezet që kanë kaluar përtej rrjetës së artë shkrihen dhe formojnë hoje të përmjaltura në portretin tim. Ndërmend filxhanin e kafesë. Në mes të gjithë atyre punëve që duhen gatitur, dhe kundërvënies tendosëse të kohës që thuajse asnjëherë nuk mjafton, forca e zakonit më shtyn drejt një kënaqësie të pamohueshme. Afro një vit më parë, në atë që njihet si sezoni i uljeve të çmendura, në një të premte të zezë, arrita të blija me leverdi një ekspres të vogël kafeje. Edhe pse mosbesuese ndaj konsumit të tepruar dhe aktit të posedimit, pas një përllogaritjeje të kujdesshme kisha dalë në përfundimin se ishte një domosdoshmëri për të shmangur rendjen e përditshme në trafik dhe zallahinë e kafeneve.

Ngrihem. I hedh një sy frigoriferit. Ka mbetur pak nga ëmbëlsira e djeshme. Pas një copë kohe pa vizitorë, zilha që ra tri a katër herë u gjallua nga fytyra energjike e Hanës, një ish kolege nga koha kur punoja në një shtëpi të vogël botimi, me të cilën ende ruaj një miqësi të përciptë. Prej pak kohësh, Hana feston ngritjen e saj në detyrë, çka në të vërtetë, ishte dhe shkaku i vizitës së beftë.

Me një vështrim kritik, që i shkon përshtat pozitës së saj të re, ajo trazoi lehtë filxhanin. Shtresa e sipërme u shkumëzua dallgë-dallgë. Pasi u bind për cilësinë e kafesë, prej buzëve të laturisura nga përqendrimi i lëngut të errët, nxori një pasthirmë kënaqësie. Më uroi

për ekspresin e kafesë, sakaq, gjurmët e buzëve të kuqe mbetën në filxhanin e bardhë.

-Them se duhet ta rimendosh këtë ftesë, - m'u drejtua Hana. - Mos refuzo menjëherë. E di që të pëlqen kjo mënyrë e pavarur jetese, gati asketike, por nuk ka ditë që zonja Hasa të mos më lutet t'ju kërkoj të punoni me ne. Për hir të së vërtetës, ajo është zonjë-grua. Nuk është si ata eprorët mbikëqyrës që të rrinë mbi kokë e të kërkojnë llogari gërmë për gërmë. Si grua me përvojë në këtë zanat, ajo i kupton mirë kufijtë, por dhe shfrenimin. Kam përshtypjen se do të shkoni mirë.

Iu përgjigja shkurt se do ta mendoja. Iu rikthye kafesë për një çast, mjaftueshëm sa të kuptonte se nuk kisha ndërmend ta bëja.

Para se të largohej, i hodhi një sy apartamentit.

- Kur të takohemi sërish, dua që këto grila të mos i shoh më kaq të mbyllura. Kjo dhomë ka nevojë për dritë të mirëqenë, jo çikërrima. Është e mobiluar kaq këndshëm për të qenë një zhguall breshke.

Dhe Hana u largua, duke lënë mbi tavolinë një kek çokollate. Për të festuar ngritjen në detyrë. Asgjë domethënëse. Për të festuar apartamentin e ri. Asgjë domethënëse.

Keku, me butësi sfungjeri, shkristohet nga dhëmbët e përndritur të pirunit metalik. Ka shijen e duarve të Hanës. I gatuar në shtëpi me përbërës të zgjedhur. Ka

shijen e kujdesit të duarve të saj që ekzekutojnë vendime të mëdha mbi brumin-tastierë.

Vështroj nga dritarja. Dua të zgjas pafund çastin para se laptopi të zërë vend në prehrin tim. Shquaj siluetën e ndërtesave më të larta. Një qytet i ri mbivendoset brenda një tjetër qyteti. Qyteti i qelqtë i pasqyrave grish çdo ditë një lartësi të re. Qyteti i vjetër kurdiset në vitin 1822.

Pas disa manovrave të thjeshta, gurgullima e zierjes më njofton se kafja është gati. Pas disa gllënjave të para, e rrufis kafënë ende të nxehtë. Shkrimet po ecin mirë. Blogu ka abonentë të rinj që regjistrohen çdo muaj. Është botuar cikli i poezive. E vetmja punë që kalon pa ndier mpirjen therëse të shpinës, ngërçet e muskujve të tejldhur apo përskuqjen e syve që lotojnë nga përqendrimi i pandërprerë. Në mes të një morie njoftimesh të palexuara e këmbimesh bashkëpunëtorësh, qëndron prej kohësh një emër i panjohur. Një emër i lënë përgjysmë, i prerë në mes me thikë. Një emër që ruan një fshehtësi gjysmake: *Alina M.*

E lexoj mesazhin e saj dhe e rikthej sërish në të palexuar. Një ritual i përditshëm errësimi dhe zbehjeje në dritarezën e *inbox-it*. Është thjesht një email pa adresë. Dhe adresa nuk jam unë.

"Po kërkoj fundin, ti më shpie kaq pranë tij".

Sa më shumë e rilexoj, aq më shumë nuk ndaloj së menduari për Alinën dhe përsiatjen e saj drejt fundit. Kam nisur t'i lexoj librat nga faqja e fundit. Kërkoj me

ngut paragrafin e fundit, fjalët e fundit, rrokjet e fundit. Numrat e telefonit arrij t'i formoj duke nisur nga fundi. Në fillim dukej gati e pamundur t'i radhisja shifrat në mendje në atë rend aq të pazakontë. E marta është dita e pazareve. Në markete hyj gjithmonë nga dalja dhe largohem vetëm pasi jam siguruar që nuk ka qenë askush pas meje në radhë.

Fundjavën e kaluar, e gjithë dita shkoi ters sepse nuk zgjodha veshjen e stivuar në fund të raftit. Lori më telefonoi herët në mëngjes. Nga zëri dukej e molisur; fjalët i dilnin me vështirësi dhe ende mezi kapërdihej nga ngashërimi. Në emër të familjes, me një lutje pothuajse përgjëruese, ngulmoi që t'i përcillja ngushëllimet e mia familjes së të ndjerit, Alfred. Gjatë gjithë bisedës e quajti "xhaxhi Alfred", mbase për ta nderuar. Mbase sepse ajo ndihej ende e vogël përballë tij. Mund të përfytyroja sesi më shihte me sytë e saj të larmë, të buhavitur. U lava dhe në nxitim e sipër zgjodha një veshje krejt të rastësishme.

Nuk bëhet fjalë për një njohje familjare dosido. Familjet tona kanë një lidhje të hershme, disavjeçare. Në qytezën ku jam rritur, Pjetri, im atë, ka qenë pronar i një studioje të njohur pëlhurash, derisa ajo ceku fundin dhe falimentoi. Ai nuk pranoi ta quante asnjëherë një dyqan perdesh. Madje, ndalonte prerazi këdo që përpiquej t'i nëpërkëmbte reputacionin, duke e zvogëluar në një sallë

të thjeshtë shitblerjeje. Kur trokëllima e tabelës hapej, në fillim ndesheshe me ndriçimin e llambadarëve të kristaltë në atelienë ku prezantoheshin veprat e derdhura të artit. Në harqe të futura në mur, imitime dritaresh, shfaqeshin modelet më të fundit. Pjetri i ndante punët e punishtes-atelie me dy mesoburra të moshës së tij. Njëri prej tyre ishte Alfredi. Në rrëmujën e prapaskenës kryhej puna e vërtetë. Pjetri ishte mjeshtri i katalogut të pëlhurave e stofeve, ndërsa dy të tjerët merreshin me marrjen e porosive, organizimin, magazinimin, metrazhet, prerjet, qepjet e kësisoj punësh. Djali, jo më shumë se katërmbëdhjetëvjeçar, i njërit prej punonjësve, shërbente si çirak dhe merrej me montimin e shinave. Meqë konsiderohej se nuk kishte ndonjë mendje kushedi për shkollë, ishte më e udhës të merrte një zanat qysh herët.

Nuk e kisha aftësinë t'i thoja Lorit "jo". As të pranoja menjëherë. Por ajo punë e ngutshme nuk mund të priste. Makina e vogël, dyvendëshe, që sapo kisha blerë, kishte rreth dy ditë tek mekaniku. Me kominoshet e vajisura, ai doli nga ofiçina me një seriozitet të frikshëm, si ai i parapërgatitjes për një kirurgji teknike të vështirë. - Defekt valvulash, rrjedhje vaji, duhen pastruar filtrat. Ndërkohë, shtrëngoja dhëmbët nga inati sesi kishte mundur të ma hidhte një shitës i rysur që shpërrallonte se makina ishte në gjendje të mbajtur dhe se, për të tillë

çmim, nuk do të gjeja më të mirë.

Atë ditë, duhma e rëndë ndihej ngado në ajrin e thatë: ca nga bataretë e të nxehtit veror që, njëpasnjëshëm, godisnin si të shtëna topthash zjarri, e ca nga moria e aromave që trazoheshin rrugëve të kryeqytetit në vaktin e mesdrekës. Herë ndiheshin si parfumosje rinore e herë si aromë urie prej zgarash mishi a peshku të skuqur.

Në stacionin qendror të autobusëve, pritja ishte e pafundme. Oraret nuk dihen kurrë. Mes trumbës së njerëzve që prisnin, e gërgitjeve se kush të nisej i pari, u ula diku nga radhët e fundit.

Lehtësimi që ndjeva se kisha gjetur vendin që kërkoja u fashit shpejt. Motori rrapëllinte pareshtur. Ajri i kondicionuar ishte i pamjaftueshëm. Frymët që dilnin ishin më tepër sesa ato që filtroheshin. Xhamat e llangosur me shenja gishtërinjsh përshëndesnin çdo pasagjer. Përshëndetja e fundit e tyre ishte stacioni i mbërritjes.

Me raste pyes veten nëse kam jetuar ndonjëherë atje. Një qytezë që shtrihet zballtshëm, as shumë në veri, as shumë në jug. As nuk i afrohet diellit të lindjes e as atij të perëndimit.

Shtëpia kishte hapur dyert e mortit. Kishte njerëz tejendane. Ziente nga zëra vajtues. Lori kishte pasur një pëlqim të fshehtë për çirakun asokohe. Jo aq për atë që ai ishte, sesa për atë që ajo përfytyronte se ai do të bëhej.

Pos të tjerash, kjo ishte një nga arsyet që ajo këmbënguli që unë të isha aty. Me trupin që ushtrohej ditë pas dite, muskujt që formësoheshin, pulpat e dala, ajo imagjinonte se në ç'burrë shpatullgjerë do të brumosej ai një ditë.

Disa nga ëndërritjet e saj ishin realizuar vërtet. Çiraku kishte hedhur trup dhe zëri i tij ishte burrëruar, po aq sa shpatullat. Tani që ai ishte burri i mbetur i shtëpisë, prova e parë e maturisë i parashtronte detyrën e mbajtjes së boshtit të familjes mbi shpatulla. Dhe, dukshëm, ai ishte përgatitur për atë ditë.

Nuk arrita të kuptoj mirë nëse më vunë re. Shqova shkarazi një vështrim disi të shastisur të çirakut nga fakti që unë isha aty. Ndoshta kishte pritur dikë tjetër. Lori do të kishte qenë ngushëllimi i duhur. Sakaq, nuk mund të përcaktoja se për kë ishte më sfilitës ai çast: për djaloshin shpatullgjerë, që nuk mund t'i lejonte vetes refleksin e asnjë grimë dobësie mes pritjeve e përcjelljeve të shumta, apo për gruan e ve, që mund të plandosej përtokë nga çasti në çast.

- Sëmundje e rëndë, - u përgjigj çiraku, pa vënë re se unë as nuk e kisha pyetur. - Por më e rëndë se ajo lëngatë ishte dëshpërimi i tij. Sa vumë gjithçka në vijë dhe... ai iku. Nuk ishte i prerë për një jetë të rehatshme. Atë e mëkëmbte e keqja dhe e mori e mira.

Në fytyrën e tij mund të lexoja atë që ai nuk mundte ta shprehte gojazi.

Ai fliste me veten e tij, sikur unë të mos isha aty. Dhe unë nuk mund të bëja gjë tjetër veçse ta dëgjoja e të hiqesha sikur po e pyesja vërtet. Kjo ishte forma ime e ngushëllimit.

Nuk kisha arsye të vizitoja shtëpinë ku isha rritur, por as ndonjë arsye për ta shmangur. Këmbët ecnin me intuitën e tyre. Ato njihnin çdo skutë. Trupi im drejtonte mendjen time, që arsyetonte pa dobi se duhej të isha stacion. Por dezertori nguli këmbë të arratisesh në shtëpi. Matanë rrugicave të shtruara me baltë, gropat e cekëta ishin thelluar nga lëvizjet e kohës. Në stinën e shirave, lloha i shndërron rruginat në baltovinë e gropat në hauze. Makinat që anohen, pllaurisin llucën në muret me avlli. Dhe largohen sikur të mos kenë bërë asgjë. Lluca mbetet mureve dhe shiu pastron çdo mëkat.

Jashtë frynte një puhi e lehtë që kishte mposhtur përkohësisht vapën përzhitëse. Në tokën e thatë, ndanë rrugicave, kishin mbirë barëra të këqija. Me të dalë nga kthina e shtëpisë së çirakut, rrugët kryesore, të shtruara sa me asfalt e ca më tutje me kalldrëm, drejtoheshin në zemrën e qytezës: atelieja e Pjetrit.

Në katin e parë të ndërtesës ishte atelieja; dy katet e mësipërme, banesa ku jetonim. Qepenat ishin të mbyllur. Tabela ku listoheshin shërbimet kishte marrë

pamje të zbërdhulët. Frazës "Gjithmonë, zgjedhja juaj", i kishin rënë vende-vende germat. Faqet e murit të shtëpisë, gjithashtu kishin nevojë për lyerje. Lulet e mbetura në ballkon ishin vyshkur.

Në xhep më vringëllonin dy kopjet e çelësave sa herë takonin njëri-tjetrin. Të dyja kopjet e çelësave të shtëpisë i kam unë.

U ndala te porta e jashtme. Nga brendia e rrugicave ndihej sezoni i shumimit. Mjaullima të zvergura e dyluftime të ethshme terroresh tokësore e mishtore.

Ndërmenda Gaton, jetën e tij plot tetëmbëdhjetë vjet. Ditët kur ishte kotele e i rrëzëllisnin sytë nga kureshtja. Koha e mplaku; gëzofi qimegjatë iu shndërrua në postiqe leshi të ndytë, me rrodhe të ngatërruara vende-vende, pa kurrfarë shkëlqimi. Dhëmbët filloi t'i humbiste një nga një dhe kohën e kalonte më së shumti duke fjetur.

Nga çasti në çast prisja që ai të kërcente mbi avlli, të shtriquej dhe të mjaullinte i uritur. Por mjaullimat vinin tepër të largëta dhe rrugët ishin bosh. U ndesha veç me një puhi kokrrizash pluhuri që kërkonte sytë e mi.

Ende e shoh atë vend në ëndërr, sikur një pjesë e imja vazhdon të ndodhet akoma e kyçur aty. Ato mure flasin një gjuhë abstrakte që mund të rroket vetëm në një hapësirë të izoluar hermetikisht të mendjes sime. Një gjuhë e mësuar dhe e lënë aty.

Rruga e kthimit ishte edhe më rraskapitëse. U sigurova ta kaloja pragun e apartamentit vetëm në orën 17:59, pas një gjysmë ore pritjeje.

Mbrëmjeve, apartamenti pllakoset nga një gjendje amullie. Herë pas here, nga rruga kryesore depërtojnë zhurma makinash. Me raste, shfaqen patrulla policie. Dëgjohen ulërime të inatosura. Nuk i kuptoj prej nga vijnë. Aspiratori i kuzhinës thith ajrin dhe, bashkë me të, sjell shtjella mërzie. Nga britmat ngjethëse, një zë duket i kalitur, ndërsa tjetri vajzëror. Çdo javë mëtoj sesi kordat zhubrosen e tejza të reja rrudhash përfaqen.

Njërin parapëlqej ta quaj zoti V. Jam e bindur që kjo është shkronja e fundme e emrit të tij. Ai kthehet gjithnjë vonë. Gjysma e parë e mbrëmjes është thujse çdo ditë e qetë. Asaj nuk i pëlqen ta neglizhojnë dhe, kur zoti V. ngre zërin, mendon se ka të drejtë t'i kërkojë një më një llogari se ç'fsheh në mendje. Frika e tij: një lidhje e mundshme paralele.

Zërat janë kthyer në rutinë. Mbrëmjeve, si gjithmonë, janë të paftuar. Në tryezë sjellin të njëjtin labirint bisedash. Kur qytetet zmadhohen, njerëzit zvogëlohen. Dhe u ngjajnë sardeleve të zhytura në një konservë të yndyrshme. I njëjti fat, i njëjti truall dhe e njëjta lëkurë e zhveshur nga luspat. Kur njerëzit zmadhohen, qytetet

zvogëlohen.

Tërheq fort shiritin e letrës. Fuqia ngjitëse shpaloset shtresë pas shtrese mbi sipërfaqen e rrjetëzuar imtësisht të aspiratorit. Duhet të asgjësoj rënkimet. Mes për mes dukjes së bardhemë të shiritave, ende depërtojnë zëra të mekur. Po mësohem të bashkëjetoj me ta. Me grindjet dhe dashurinë e tyre të pakuptimtë.

Kur më nevojitet qetësi ndez një cigare në ballkon. Në ballkonin e ndërtesës përbri, një hije, e strukur nën zgavrën e një kapele të hirtë, me një shall të hollë pambuku nën hundë, të po së njëjtës ngjyrë, që nuk dallohet qartë nëse është burrë apo grua, përhahet edhe më në errësirën e natës dhe humbet si vegim. Është dita e prezantimit. Mbështetem në parmak. Hija nuk lëviz nga ndenjësja. Teksa unë tymos me nge, në anën tjetër fjolla e tymit të duhanit tërhiqet pareshtur në ajër. Dëgjohet zhurma e çakmakut. Hija ndez disa cigare radhazi, duke i ngjeshur në tavëll para se ato të shuhën plotësisht. Pastaj qëron fytyrën nga këlbaza dhe duket sikur mbytet në atë lëng veshtullor. Me siguri nuk ka pritur askënd.

Në mëngjes, vagëllimthi, ndeshem me Zotin V. në korridorin gjysmë të ndriçuar të hyrjes. Një burrë me fytyrë të rruar, ku zgjatime gjembore, vende-vende të thinjura, sapo kanë nisur të shpojnë lëkurën e vrazhdë. Aq të vrazhdë sa zëri i tij i regjur që flet me zë të lartë

në telefon, në përpjekje për të kolonizuar çdo hapësirë. Kam mësuar t'i njoh njerëzit nga zërat e tyre. Nga radioja e vogël në gurmaz. Mund t'ua harroj lehtësisht portretet, por zërat jo. Njerëzit nuk janë në gjendje të luajnë instrumentin e zërit të tyre. Është krejt e kundërta. E gjithë qenia vihet në shërbim të zërit.

Kur zoti V. largohet, nga pas mund të dëgjoj zhurmën e ashensorit që mbase po nisët a po kthehet nga ndonjëri prej kateve të pallatit nëntëkatësh.

Zakonisht e shmang ashensorin. Ndonjëherë tundohem të përgjoj ndonjë bisedë. Është e vetmja mënyrë të kuptoj se ku ndodhem. Një qytet ka aq fytyra sa ka edhe njerëz që jetojnë në të.

Ato ulje-ngjitje të shkurtra janë akte gjuetie. Shikime të vëngërta. Cepat e syve që përcjellin me pikëpyetje një tjetër palë sysh. Këpucët mërgojnë qoshkave dhe përshëndetje të sipërfaqme u bishtnojnë buzëve që, në më të shumtën e rasteve, nuk duan të thonë asgjë. Në fund, preja bëhet gjuetar dhe gjuetari, pre.

Mbrëmjen kur, në zënkë e sipër, diçka e xhamtë thyhet copa-copa, aspiratori gjakoset. Disa dritëza llamburijnë njëherazi në apartamentet fqinje. Askush nuk guxon t'i telefonojë policinë. Mbrëmja pllakos sërish.

Dal në tarracë. Në një nga ato ditë kur sherrnaja bëhet e padurueshme. E bëja shpesh kur jetoja në shtëpinë e prindërve. Qielli duket më pranë, tymnaja më larg. Pres

të jem vetëm, por nuk jam. Duhet të jetë ajo. Kthen kokën; syzet e gjera miope, me kornizë të bardhë, fshehin të nxirat. Qëndron kaq pranë murit. Kur sheh se nuk jam Zoti V., kthehet me shpinë. Sheh përmjergullas më shumë poshtë sesa lart. Dukshëm, nuk ka dalë për qiellin. Instinktivisht, manovroj gishtërinjtë e bashkuar në formë drejtkëndëshe. Drita fosforeshente shkrepet dhe përndrit flokët e saj të kërleshur nga era.

Dua ta fotografoj atë çast. Të regjistroj hedhjen. Pres që njëra këmbë të hopë përpara. Pastaj, ndoshta t'i them: "Kthehu veç një çast. Buzëqesh pak për mua... për thjerrën e aparatit."

Dhe ta shoh teksa prek fundin.

Afrohem pranë murit. Nga xhepi nxjerr paketën e cigareve. I zgjat njërën.

- Ai nuk do të të ndjekë pas.

E zënë në befasi, më sheh ngultazi pak çaste.

- Nuk të njoh.

- As unë.

Kur merr cigaren, më bën me shenjë t'ia ndez. Me njërën dorë përpiqem të bllokoj ajrin. Sytë tanë ndeshen një çast dhe mbase kupton se nuk i duhet një fytyrë që ta njohë. E shpëtoj atë mbrëmje. Por nuk mund ta bëj gjithnjë.